



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 35/2011
Prishtinë, më 11.10.2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Fikrim Damka, Sala Berisha - Shala, Hashim Deshishku, Lutfi Zharku, Myzejene Selmani, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Teuta Sahatçija dhe Berat Buzhala.

Pjesëmarrës i ftuar: Fehmi Mujota, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës.

Pjesëmarrës të tjerë: Banush Pacolli zv.ministër – MI, Skender Gashi, Lah Nitaj, Ramë Qupeva Besnik Hajdari – MI, Ukë Gashi – ZPRK, Ilir shala, Eric Hoyri, konsulentë - MI dhe Sanije Berisha – OSBE.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 04. 10. 2011;
3. Raportim i ministrit z. Fehmi Mujota për gjendjen e infrastrukturës në vend dhe për aktivitetet e Ministrisë së Infrastrukturës;
4. Propozimagjenda e Komisionit për aktivitetet në muajt e ardhshëm;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 04. 10. 2011

Procesverbali i mbledhjes datës 04. 10. 2011 u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i ministrit z. Fehmi Mujota për gjendjen e infrastrukturës në vend dhe për aktivitetet e Ministrisë së Infrastrukturës

Kryetari – Për këtë pikë të rendit të ditës, jemi pajtuar nga mbledhja e kaluar që ta ftojme z. Mujota, ministër në Ministrinë e Infrastrukturës, i cili do të paraqesë një ekspozë të përgjithshme para anëtarëve të Komisionit Funkcional për gjendjen e infrastrukturës në vend dhe për aktivitetet e Ministrisë së Infrastrukturës.

Fehmi Mujota (ministër i Ministrisë së Infrastrukturës) – E paraqiti në vija të përgjithshme punën dhe aktivitetin shtatëmuor të Ministrisë që e drejton. Theksoi së gjatë punës së deritanishme, aktivitetet e MI-së janë përqendruar në realizimin e objektivave të përcaktuar më planin e punës për vitin 2011. Në mënyrë kronologjike i ceku projektet dhe aktivitetet e MI-së, siç është edhe Autostrada Vërmicë - Merdare (R7). Projekti i autostradës ka avancuar shumë gjatë vitit 2011. 38 km e para do të lëshohen për qarkullim deri në fund të tetorit të këtij viti. Tashmë seksionet 1, 2, 3 dhe 4 janë përfunduar në masën 93%, ndërsa po punohet edhe në seksionin 5. Kompania mbikëqyrëse “Hill International”, është mobilizuar, ndodhet në terren dhe po e bën inspektimin e punimeve. MI-ja me kompaninë projektuese dhe BEGP-në i ka menaxhuar drejtë shpenzimet e Projektit, sipas buxhetit të parashikuar me kontratë. Bashkëpunimi i mirë me të gjitha palët dhe zgjidhja e pengesave pronësore kanë bërë që 38 km e para të kryhen para afatit, në kohë rekorde prej 18 muajsh. Hapat e mëtejshëm janë përfundimi i punëve në Seksionin 4 dhe puna për kycje në Duhle, para verës së vitit 2012. Seksionit 5 do të përfundohet brenda vitit 2012, me të cilin Autostrada lidhet me rrugën M9 në veri të Malishevës. Do të nisë puna në seksionet e fundit 7, 8 dhe 9, në mes të vitit 2012, ndërsa përfundimi i Projektit, në veri të Prishtinës, para fundit të vitit 2013. Shtoi më tej se janë nënshkruar marrëveshjeve bashkëpunimi për transport ndërkombëtar me Bullgarinë, Turqinë, Belgjikën, Shqipërinë dhe me Kroacinë. Me Maqedoninë është nënshkruar marrëveshja për transportin hekurudhor të udhëtarëve dhe të mallrave. Janë negociuar dhe janë përafuar marrëveshjet me disa vende, si: Zvicra, Mali i Zi, Austria, ndërsa punohet me Maqedoninë për fushën e transportit rrugor. Në fushën e aviacionit civil janë lëshuar 34 leje për operime të rregullta dhe 102 leje për fluturime ad-hoc për kompanitë ajrore, kryesisht nga BE-ja. Sa i përket inspektoratit, janë inspektuar 1472 automjete të udhëtarëve dhe të mallrave, janë përpiluar 521 procesverbale përkatëse janë lëshuar 184 vendime për përjashtim të automjeteve nga komunikacioni rrugor, janë lëshuar 54 vendime për eliminimin e të metave në transportin rrugor, janë lëshuar 13 vendime për eliminimin e të metave në stacionet e autobusëve, janë proceduar 17 lëndë për leje ndërkombëtare, janë iniciuar 2 lëndë për licencim, ndërsa janë ndaluar dhe janë larguar nga komunikacioni kombibusë të shumtë në të gjitha drejtimet, janë kthyer nga pikat kufitare 47 autobusë, janë përpiluar 158 procesverbale, janë iniciuar 11 lëndë në gjykatën kompetente, janë bërë 273 inspektime të rregullta në QKTA, 102 inspektime të jashtëzakonshme në QKTA, 581 inspektime me Policinë e Trafikut, 10 vendime për eliminimin e parregullsive, 4 vendime për mbylljen e përkohshme të punës së qendrave, 4 inicime të procedurave për kundërvajtje në gjykatat komunale dhe 2 inicime të procedurave për revokimin e licencave të qendrave të kontrollit teknik. Është hartuar Draftligji për orët e ngasjes dhe për implementimin e programit të

“tahografit digjital”; është hartuar Udhëzimi administrativ për licencimin e operatorëve të transportit rrugor të mallrave, ndryshimi i Udhëzimit administrativ për rrjetin e transportit ndërrurban, është bërë amendamenti i Udhëzimit administrativ për subvencionimin e transportit dhe amendamenti i Udhëzimit administrativ për testimin e automjeteve për transportin e mallrave të rrezikshme; është bërë licencimi dhe rilicencimi i operatorëve të transportit të udhëtarëve, të mallrave dhe të mallrave të rrezikshme, si dhe i terminaleve të mallrave dhe i stacioneve të autobusëve. Nga Departamenti Ligjor është hartuar Projektligji për hekurudhat e Kosovës, Projektligji për themelimin e Agjencisë për Shërbimin e Navigimit Ajror dhe Projektligji për ndryshimin dhe për plotësimin e Ligjit nr. 02/L-70 për siguri në komunikacionin rrugor, Udhëzimi administrativ nr. 1/2011, për ndryshimin dhe për plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 2008/9, për dhënien e provimit për shofer; janë përcjellë zbatimi i elaboratit të shpronësimit në segmentin e 5 dhe plotësimet shtesë të shpronësimit në segmentet 1, 2, 3, dhe 4, si dhe zbatimi i elaborateve të shpronësimit në rrugët M-2 dhe M-9. Janë organizuar pesë takime të trupit të punës për „infrastrukturën“ dhe katër takime të nëngrupit punës për “transportin”, pjesëmarrja në takimin sektorial, në kuadër të dialogut të Procesit të Stabilizim-asocimit për “infrastrukturën” me përfaqësuesit e KE-së, pjesëmarrja në takimin plenar të dialogut të Procesit të Stabilizim-asocimit, lidhur me progresin në kuadrin e PVPE-së. Realizimi i buxhetit për vitin 2011 janë paga dhe mëditje: 1,210,518.00 €, janë shpenzuar: 871,915.63 €, ose 72%; mallra dhe shërbime: 910,239.00 €, janë shpenzuar: 681,007.22 €, ose 74.8%; shërbime komunale: 108,590.00 €, janë shpenzuar: 66,953.67 €, ose 61%; subvencione dhe transfere: 2,103,814.00 €, janë shpenzuar: 1,132,012.72 €, ose 53.8%. Ministri Mujota i ofroi Kryetarit të Komisionit material me shkrim për politikat e Ministrisë dhe njëherësh i dorëzoi solemnisht edhe Masterplanin për ndërtimin e Autostradës Prishtinë – Shkup.

Kryetari – Shtroi disa pyetje lidhur me interesat ekonomike dhe për synimet të disa rrugëve, që kanë të bëjnë me disa zona me vendet fqinje, siç është një pjesë me Malin e Zi, nga Deçani, ose një rrugë tjetër që ka qenë mjaft e frekuentuar, me pjesën e lindjes, që lidh Kosovën me zonën e Prishtinës, të Bujanocit etj. I shtroi edhe këto pyetje: Çështja që lidhet me cilësinë që ju e përmendët, me inspektimin e këtyre autoshollave, sa kemi kualitete, a kemi kriteret për angazhimin e kontrollimit të atyre ekspertëve? Po ashtu është edhe çështja e homologimit të këtyre automjeteve, a ka mundësi që ta ketë një kompani një të drejtë të tillë, dhe a e ka Ministria ndërmend ta rishikojë punën e çështjes së homologimit?

Visar Ymeri – Për pyetjen e parë, që lidhet me çmimet e kontratës, nuk kam marrë asnjë herë arsyetim nga Qeveria. Edhe ne si Lëvizje Vetëvendosje, që kemi parashtruar pyetje lidhur me këtë, nuk kemi marrë përgjigje. Pse këto çmime, në përgjithësi, janë aq të larta, edhe pse Qeveria e Kosovës e ka pranuar një gjë të tillë, të paguajë një çmim aq të lartë më shumë se sa është çmimi i tregut? E dyta ka të bëjë me çështjen e para dy apo tri ditëve të fundit, kur është publikuar në shtyp një deklaratë e këshilltarit tuaj z. Nitaj, në të cilën thuhet se është paguar rreth 320 milionë euro për punën që është kryer deri më tani për autostradë. Po supozoj se ka të bëjë me këto 38 kilometra që janë përfunduar deri më tani. Në bazë të kësaj, nëse vazhdojmë me rritjen e kostos, sa do të jetë numri i kostos përfundimtare në tërë autostradën? A jemi në pozicion tani ta bëjmë një kalkulim të tillë? Thatë se Qeveria edhe Ministria juaj e ka bërë mbikëqyrjen. A jemi ne të sigurt se kjo Ministri do të jetë mbikëqyrëse për një projekt kaq madhor? Pra, a kemi kapacitete në sektorin publik? Kemi informacion se njëri prej personave në kompaninë mbikëqyrëse është person që ka punuar më herët në Bektel Enka, e tani është në “Hill International”, kompani që është duke bërë mbikëqyrjen e autostradës. A mendoni se ka konflikt interesi këtu? Po ashtu punët kanë filluar për shpronësimet për Seksionin e pestë. Nëse Qeveria e ka kontraktuar këtë për Seksionin e pestë, a ka siguruar Qeveria mjete financiare për këtë çështje? Edhe tani për rrugën “6” ju thatë se po i shikoni të gjitha burimet financiare për të filluar. Cilat janë ato mundësi dhe cilat janë alternativat? A është vetëm buxheti apo është edhe

ndonjë alternativë tjetër që mund ta financojë këtë rrugë? Po ashtu a ka bërë Qeveria vlerësim të racionalitetit dhe të fizibilitetit, që i jep prioritet kësaj rruge?

Myzejene Selmani - Duke filluar nga materiali, që na e ka sjellë z. ministër, unë do të ndalem vetëm të çështja e financimit të vitit 2012. Këtë e bëj për arsye se gjatë draftimit të projektbuxhetit të vitit 2012 do të parashihet buxhet për të gjitha dikasteret. Do të ndodhë që në vitin 2012, të gjitha mjetet që planifikohen nga Ministria e Infrastrukturës do të dedikohen në projektet e autostradës. Ndoshta do të vijë koha të merren parasysh edhe projektet e tjera, por ju e potencuat edhe me herët se Projekti i autostradës është i harmonizuar edhe me shpenzimet afatmesme, që do të thotë se do të vazhdojë deri në vitin 2013. Te çështja e kompanisë mbikëqyrëse është vendosur më vonë. Ju e dini se keni pasur problem deri në vendosje e një kompanie për mbikëqyrjen e autostradës, por edhe pse kompania ka ardhur me vonesë. Si do të shkojë puna deri në fund të Projektit do të shohim. Nuk e di se a do të kryhen punët e autostradës para verës të vitit 2012. Mund t'ju njoftoj se për këtë janë paraqitur disa probleme gjatë shpronësimit. Mirëpo ju nuk jeni të përfshirë direkt në çështjen e shpronësimit, Për këtë përgjegjëse është Ministria e Financave. Ajo e ka departamentin e vet, brenda Ministrisë, që duhet të japë përgjegjësi për çështjen e shpronësimit. Kërkoj nga Ministria të ketë konsideratë gjatë shitjes së tokave, për arsye të tokave bujqësore, të cilat po kalojnë disa segmente. Kemi pasur sugjerime nga qytetarët për kalimin e këtyre segmenteve. Do të kisha ndalur të çështja e Autostradës Prishtinë – Shkup. Ju thatë se do të gjendet një mënyrë e financimit. Kisha sugjeruar të përfundojë së pari Autostrata Vermicë - Merdar, pastaj ta shohim çka do të ndodhë me Autostradën Prishtinë – Shkup, sepse të gjithë e dimë se si qëndrojmë financiarisht. Sa i përket çështjes së inspektimit të inspektoratit, kur e përmendi edhe kryetari çështjen e homologimit, mendoj se ka metoda të zgjidhjes. Do ta parashtroja një pyetje lidhur me çështjen e transportit të mallrave të rrezikshme, sepse e keni një Udhëzim administrativ për transportin përmes Maqedonisë. Për këtë dua përgjigje të drejtpërdrejtë prej ministrit. Marrëveshjet e bashkëpunimit, që i potencuat, besoj se do të jenë në favor tonin. Për çështjen e aviacionit ju e dini mjaft mirë se është përfshirë në bisedimet teknike. Do të theksoja se të gjitha autoshkollat, që janë territorin e Kosovës, janë përgjegjësi e një departament që e keni ju brenda Ministrisë. Duhet të keni kujdes, siç thatë pak më parë, që të mos bëhen keqpërdorime. Edhe zyrtarët e Ministrisë, por edhe departamenti kryesor të dihet si po funksionojnë. Të mos keqpërdoret as emri i ministrit e as emri i zyrtarit, për çështje që i përkasin iks personave. Ju e potencuat sa e keni buxhetin dhe si është shfrytëzuar. Do të doja të dija si ka filluar projekti i Autostradës dhe pse shumë projekte kanë mbet në gjysmë? Është dashur të mbulohen disa pagesa, siç është çështja e mallrave dhe e shërbimeve, që i duhen Ministrisë. Pjesa më e madhe e shpenzimeve kapitale është për autostradën dhe për projektet, që nuk janë përfunduar në mandatin e Qeverisë së kaluar.

Hashim Dëshishku – A përfshihet në projekt të Ministrisë zgjerimi i rrugës Prishtinë - Podujevë? Dua të di po ashtu lidhur me rrugët që kanë filluar për Mitrovicë dhe për Pejë. Aty po fillohet dhe nuk po bëhet shpronësimi, d.m.th ka ngecje. Pra po hasim në probleme që e pengojnë vazhdimin e punës për rrugët. A është në plan në të ardhmen që të mos fillohet me punë në rrugë pa u bërë shpronësimi? Më intereson edhe për urën e Fushë Kosovës. Rruga që vjen nga Mitrovica, kthesa në rrethrotullim, për kamionë, paraqet problem, sepse është shumë e vogël. Gjatë projektimit a është bërë një analizë më e thellë për këtë rrethrotullim dhe a keni bërë revidimin e këtij projekti?

Ramiz Kelmendi – Duhet të dimë saktësisht sa është numri i punëtorëve, pjesëtuar për orë pune, që janë punësuar në ndërtimin e autostradës dhe sa është numri i vendeve të punës që kanë humbur te ekzekutuesit e kaluar në ndërtimin e rrugëve? Pastaj duke parë se çka po ndodh me kompanitë tona të ndërtimeve, në ndryshueshmërinë e kapaciteteve të vetvetes dhe të tjerëve, duke i shuar ato kompani, dhe duke u besuar kompanive të tjera, duke u bërë nënkontraktorë të

këtyre kompanive, si qëndron gjendja në këtë drejtim? Sa i përket mbikëqyrjes, ndoshta keni mund ta angazhoni Universitetin e Prishtinës, që ka krijuar kuadro që dinë të projektojnë dhe të mbikëqyrin rrugë. A kemi ekspertë të kësaj fushe? Te kontrollimi teknik, ku behet ndarja proporcionale e të hyrave, thjeshtë zbatohet metodë komuniste. Aty po vlerësohet njësoj, ai që punon me shumë me atë që nuk punon fare.

Fikrim Damka - Sipas raportit të shkruar nga ju, keni potencuar se puna në autostradë do të vazhdojë me të njëjtin intensitet. Mirëpo ka shqetësime që i kemi vërejtur në terren. Në fund të muajit do të largohen 1000 deri në 1500 punëtorë nga puna. A keni kontakt me Bektel Enken për këtë çështje dhe a është kjo e vërtetë? Sa i përket patentave për shoferë ju e dini se në Prizren jeton edhe një pjesë e komunitetit turk dhe gjuha turke është gjuhë zyrtare, por testet për patentë shoferë nuk janë në gjuhën turke. Kërkoj përgjigje për këtë. Në hyrje të spitalit International, në dalje të Prishtinës, ka barriera. Ministria e Infrastrukturës nuk po lejon hyrje nga rruga, ndërsa në të njëjtën rrugë kemi vërejtur se për disa pompa të benzinës janë hequr barrierat, si qëndron çështja këtu?

Sala Berisha Shala – Pyeti në lidhje me bashkëpunimin e Ministrisë me nivelin komunal. E ngriti si çështje magjistralen Prishtinë – Pejë, në të cilën ka shumë pengesa të ngritura. Në rrugën e Fushë Kosovës janë të vendosura pengesat. Shenja e vozitjes është 60 km/h, ndërsa kemi ndalesa shumë afër njëra-tjetrës. Rekomandoi që Ministria të bëjë marrëveshje sa më të mirë dhe sa më të shpejtë me nivelin komunal për këtë çështje.

Biserka Kostiq – Shfaq shqetësimin lidhur me materialin dhe me informacionet e ardhura më shkrim nga ana e Ministrisë, sepse mungon materiali në gjuhën serbe. Kjo i shkakton problem në debat.

Fehmi Mujota (ministër i Ministrisë së Infrastrukturës) - U përgjigj në pyetjet e shtruar nga deputetet: Shqetësimi që u ngritë në fund lidhur me raportin, që nuk është dërguar edhe në gjuhën serbe, është rastësi dhe plotësisht keni të drejtë për shkak se në shpejtësi është përgatitur ky material, përndryshe raporti zyrtar ky që është këtu do të jetë edhe në gjuhën serbe, ashtu si e përcakton ligji dhe Kushtetuta. Çështja se a do të shkohet në drejtim më të mirë, lidhur me Malin e Zi, me Serbinë, po ju them që autorizimi e projektit për aprovimin e fizibilitetit, që po mendohet të shtrohet, Prishtinë – Shkup, të jetë në drejtim të Gjilanit. Drejtimi për në Malit të Zi, që tani e kemi vendosur si njërin nga projektet, që është kërkesë e buxhetit për vitin 2012-të, nuk jemi të sigurt se a do të aprovohet a jo. Siç potencuat edhe ju ka shumë shqetësime nga aspekti i ndërtimeve të prioritetëve të këtyre mbulesave buxhetore, por është dorëzuar një projekt, që do të lidhe Deçanin dhe Plavën. Bashkëpunimin me komunat e kemi të mirë, por ka nevojë që të përforcohet ende ky bashkëpunim. E di se edhe në të kaluarën ka pasur bashkëpunim të mirë midis kryetarëve të komunave. Nuk do të kemi projekte të reja që kanë karakter nacional dhe që kanë karakter që i mbulon Ministria e Infrastrukturës, është fjala për magjistralet që i mbulon Ministria, para se të kemi natyrisht projekte të sakta para se ta kemi elaboratin e shpronësimit, para se të kemi vlerësimin e pronave edhe para se të kemi vendimin përfundimtar. Te çështja e autostradës, ku z. Visar i ka ngritur disa çështje, shumica e pyetjeve kanë qenë edhe në debatin e organizuar enkas për këto çështje. Dua të tërheq vëmendje në dy ose tri çështje: E para është se kjo kontratë për autostradën është nënshkruar shumë më herët. Ka ekzistuar një komitet ndërministror deri në ardhje të këtij rezultati. Jam i koncentruar 100% dhe kështu duhet të ketë qenë projektit. Ka mundësi që në projektet e ardhme të punohet edhe më mirë, se ç'është punuar deri më tani, por duke ta marrim parasysh se projekti po zbatohet në bazë të kontratës së nënshkruar, mbi bazën e parashikimeve financiare të nevojave të vendit për infrastrukturë. Dua ta garantojë Komisionin Funksional se buxheti për vazhdimin i autostradës është i projektuar, është i siguruar dhe është i garantuar me Ministrinë e Financave në bazë të dy varianteve. Do të shohim se për vitin 2012, do të parashihen 240 milionë për vazhdimin e punës. Duhet shtuar

edhe 56 milionë për shpronësimet, dhe 296 milionë do të jenë për zotimin e punimeve dhe për shpronësimet. Natyrisht shqetësimi për mbikëqyrjen e autostradës, që është ngritur këtu, sigurisht që ka qenë një proces paksa i zvarritur për përzgjedhje të kompanisë mbikëqyrëse. Të gjitha procedurat janë drejtuar nga Departamenti i Prokurimit. Na gëzon fakti që kompania profesionale, e cila e ka përcaktuar kontratën, është kompani ndërkombëtare dhe ka dashur ta vlerësojë kapacitetin e kompanive tona. Me gjasë do të ketë kohë që edhe kompanitë tona do ta dëshmojnë vetën që mund ta mbikëqyrin dhe të bëjnë punë cilësore. Po ashtu, për hapësirën ajrore, po ju informoj më shkurtimisht. Deri më tani hapësira ajrore është e kontrolluar nga NATO-ja. Ka pasur diskutime, ka edhe tani. Për koincincidencë, unë sot kam pasur një takim me një delegacion të aviacionit civil nga Hungaria, që ka shprehur interes për të konkurruar deri sa të kalojnë kompetencat në kontrollimin e aviacionit të Kosovës. Për këtë e kemi përkrahjen edhe nga presidentja dhe kryetari i Kuvendit dhe nga kryeministri. Prioritet tona për rrugët, që e përmendi z. Dëshishku, do t'i kemi parasysh. Për rrugën në drejtim të Podujevës, e kemi bërë një projekt që e mbulon shumicën e komunave të Kosovës, që lidhen me rrugët magjistrale. Orientimi ynë ka qenë, edhe në drejtim të Podujevës, edhe në drejtim të Ferizajt. Sa përket pyetjes së z. Damka, mund të them se edhe testi përfundimtar për patentat e shoferëve, si dhe për largimin e punëtorëve, do të zbatohet ligji edhe do punojmë sipas rregullave ligjore.

Ramë Qupeva (Ministria e Infrastrukturës) – Dha sqarime sa i përket çështjes së çmimit. Fizikisht janë 41.8 km, ku duhet të bëhen punimet. Punimet duhet të përfundojnë në 38 kilometra, që do të thotë se kostot janë në punimet fizike dhe në instalimet. Është edhe pjesa tjetër që ka të bëjë me sjelljen e rrymës, për arsye se kjo është autostradë e tipit të mbyllur dhe të gjitha kyçjet duhet të jenë të pajisura me rrymë elektrike për nevojat e mëtutjeshme të autostradës. Të çështja Hill International, kompania mbikëqyrëse është përzgjedhur në bazë të projektit profesional dhe ka qenë bazë për përzgjedhjen e kompanisë. E kemi një ekip prej 15 inxhinierëve që e kanë përcjellë të mos them 24 orë punimet. Pajtohem edhe me ju z. Kelmendi, por Universitetit i Prishtinës nuk ka katedra specifike të të gjitha niveleve. Sa i përket segmentit të pestë, çdo segmenti i jepet leja pas procedimit dhe verifikimit adekuat. Për segmentin e pestë ende nuk kemi filluar, por është duku u bërë identifikimi i instalimit të lartë. Segmentet 8 dhe 9, përgjatë Prishtinës, është dashur të ndryshohen për shkak të Pakos së Ahtisarit. Kemi qenë të detyruar ta bëjmë riprojektimin, duke e eliminuar bazën e Gazimestanit, por pika e fillimit që ka qenë Prishtina, do të jetë e njëjtë, dhe pika dalëse që ka qenë Besia do të jetë po ashtu e njëjtë. Autostrada për Shkup, për informimin tuaj, është bërë studimi i fizibilitetit të ambientit momental, komplet elaborati për çështjen e shpronësimit është përfunduar, projekti zbatues është përfunduar në harmoni me të gjitha kriteret në bazë të Bankës Botërore dhe të Fondit Monetar.

Hashim Dëshishku - Kërkoj sqarim lidhur me rrethrotullimit e Stacionit të Autobusëve, se a është gabim auditimi apo implementimi i Projektit.

Ramë Qupeva (Ministria e Infrastrukturës) – Sqaroi se dobësia është te projektimi që e ka bërë komuna e Prishtinës, kurse Ministria vetëm e implementon Projektin.

Myzejene Selmani - A jeni duke e përcjellë çështjen e koncensionimit të Aeroportit?

Fehmi Mujota (ministër i Ministrisë së Infrastrukturës) - Nuk është detyrë e drejtpërdrejt e Ministrisë sonë. Ne vetëm përgatisim bazën ligjore, përgjegjëse për të tjerat është Ministria e Financave.

Visar Ymeri – Kërkoj sqarim për krejt punën që është bërë deri me tani në autostradë, jo vetëm për ato tri segmente. Pyeti: A mund ta kalkulojmë një kosto të gjithmbarshme të autostradës për të cilën nuk u përgjigjët? A është tejkaluar një segment 100%?

Ramë Qupeva (Ministria e Infrastrukturës)– Ju keni shumë të drejtë. Në kontratë është paraparë që çdo segment të jetë 120% e shumës. Tash jemi brenda 120%-it, edhe pse 100%-i është tejkaluar dhe në secilin segment, por jemi brenda kushteve të kontratës.

Pas debatit Komisioni nxori

Konkluzion

Komisioni do të vazhdojë me mbikëqyrjen e punës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe të secilës ministri në kuadër të fushëveprimit dhe të mandatit të Komisionit dhe të Kuvendit.

4. Propozimagjenda e Komisionit për aktivitetet në muajt e ardhshëm

Kryetari - Paraqiti propozimagjendën për aktivitet të radhës, lidhur me fushën që e mbulon Komisioni Funkcional para anëtarëve të Komisionit.

Komision pas debatit i nxori këtë

V E N D I M

1. *Te organizohen Konferenca, tryeza, punëtori dhe vizita tek agjencitë e pavarura;*
2. *Aktivitetet, sipas pikës 1, të trajtojnë temat, si: çështjet e privatizimit; fuqizimi dhe ruajtja e pavarësisë së agjencive të pavarura, që janë nën kompetencën e Komisionit; dhe studime dhe analizim i legjislacionit në favor ose në mbështetjen e prodhimit vendor;*
3. *Njësia koordinuese e Komisionit të hartojë planin e veprimit dhe të vendosë kontakte me organizata që e mbështesin Komisionin, për realizimin e këtyre aktiviteteve.*

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Kryetari - I njoftoi anëtarët e Komisionit për vizitën në Republikën e Shqipërisë, që është paraparë nga Komisioni. Po ashtu njoftoi se është konfirmuar agjenda nga ana e Ambasadës së Shqipërisë, për të cilën janë caktuar datat 24 dhe 25 tetor 2011.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetari i Komisionit